

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist** pranë **FSHU** / Departamenti i Menaxhimit të Kontratave / Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave dhe Verifikimit të Tarifave / Sektori i Shqyrtimit dhe Përpuethshmërisë së dokumentacionit.

SPECIALIST

Të sigurojë shqyrtimin ligjor dhe administrativ të kërkesave dhe ankesave të abonentëve, duke garantuar përputhshmërinë e dokumentacionit dhe aplikimin korrekt të tarifimit sipas legjislacionit në fuqi dhe procedurave të brendshme.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Shqyrton kontratat e abonentëve nga pikëpamja ligjore për kërkesat e ndryshimit të tarifimit (në rritje ose në zbritje), në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Kontrollon dhe verifikon dokumentacionin përkatës për kërkesat dhe ankesat e paraqitura, duke u bazuar në udhëzimet e punës dhe aktet ligjore në fuqi.
- Analizon të dhënat e konsumatorëve dhe historikun e kontratave për tarifimin, duke hartuar plan veprimi për sistemimin e tyre.
- Shqyrton dhe trajton ankesat e abonentëve, duke përgatitur kthim-përgjigje zyrtare në përputhje me procedurat dhe legjislacionin përkatës.
- Verifikon çështjet e aplikuara nga abonentët për ndryshim tarifimi dhe dokumentacionin e ngarkuar në sistem, duke ndërmarrë veprimet përkatëse:
 - Refuzon çështjet në rast parregullsish në dokumentacion, duke dokumentuar arsyet në sistem;
 - Kthen çështjet për rivefikim pranë strukturave përkatëse (OSSH sh.a) kur është e nevojshme;
 - Trajton çështjet e plota dhe në përputhje, duke përgatitur shkresën “memo” dhe duke realizuar sistemimin e tarifimit (rritje ose zbritje).
- Përgatit raporte periodike (ditore dhe mujore) mbi ecurinë e punës, trajtimin e çështjeve online dhe ankesave të protokolluara nga abonentët.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Arsim i lartë në drejtësi, ekonomi ose fusha të ngjashme;
- Njohuri të mira të legjislacionit përkatës dhe procedurave administrative;
- Aftësi analitike dhe vëmendje ndaj detajeve;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe raportimi;

- Njohuri në përdorimin e sistemeve elektronike dhe databazave.
- Preferohet të ketë eksperiencë të ngjashme pune.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.